



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:054918

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05728916

C.nr.984/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, me bashkëpunëtoreshen profesionale B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditëses T.S.B. me numër personal nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqësojnë avokatët B.K. dhe F.G., që të dy nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 2,842.56 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 24.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit T.S.B. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

II. DETYROHET e paditura, që paditësit, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 14.02.2019 apo për 21 muaj e 26 ditë (për çdo muaj shumën prej 20.22 euro, në shkallë prej 19% të pagës bazë- 393.00 euro dhe për 26 ditë shumën prej 17.52 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej **442.14 euro**, si dhe për periudhën kohore 15.02.2019 deri më 18.04.2021, apo për 26 muaj e 6 ditë (për çdo muaj shumën prej 51.66 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë - 393.00 euro dhe për 6 ditë shumën prej 10.33 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej **1,353.49 euro**, në shumën e përgjithshme **1,795.63 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë më datë 23.03.2022 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 144.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 2,842.56 euro, përkatësisht shuma prej 1,046.93 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

A r s y e t i m

Paditësja T.S.B. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqësojnë avokatët B.K. dhe F.G. që të dy nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e

Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 2,842.56 euro.

Të autorizuarit e paditësit në padi, kanë theksuar se paditësja është e punësuar si mësimdhënës pranë SHFMU “Zef Lush Marku” në fshatin Velezhë, komuna e Prizrenit, ku vazhdon të punojë në këtë institucion. Tutje, ka theksuar se për kualifikimin e paditëses me diplomë të fakultetit 3 apo 4 vjeçar, duhet të bëhet kompensimi shtesë prej 27% të vlerës së pagës bazë, e cila është 421 euro, apo shuma e gradimit 113.67 euro, ku aktualisht i paguhet vetëm shuma prej 54.45 euro, përkatësisht 59.22 euro në muaj më pak. Të njëjtit për 4 vite pune nga data 18.04.2017, e deri me datë 18.04.2021, janë bërë 48 muaj, të cilat shumëzohen me shumën prej 59.22 euro del shuma e përgjithshme prej 2,842.56 euro. Andaj, ka propozuar që të aprovohet e bazuar kërkesëpapia e paditësit, të detyrohet e paditura t’ia kompensojë shumën e përgjithshme prej 2,842.56 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, me kamatë ligjore prej 8%. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditësit se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësi nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësi ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpapia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpapia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja T.S.B. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë SHFMU “Zef Lush Marku” në fshatin Velezhë, Komuna e Prizrenit. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

Në këtë drejtim, gjykata përmes kontratës së punës nr. 69/18 e datës 01.09.2018, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e edukimit dhe studimet i ka mbaruar me datë 15.02.2019, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 134, e datës 18.07.2019 e lëshuar nga

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i programit parashkollor. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 393.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 54.45 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj, meqë këto dokumente, përkatësisht kontrata e punës, licenca dhe lista e pagave janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësit t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditëses ia ka paguar shumën prej 54.45 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 4 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja përfiton ngritje prej 19% të pagës bazë, për periudhën nga data 18.04.2017 deri me datë 14.02.2019, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 74.67 euro, ndërsa përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë, për periudhën nga data 15.02.2019 deri me datë 18.04.2021, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 106.11 euro, andaj paditëses i takon pjesa e diferencës së papaguar lidhur me pagën bazë në shumë prej 393.00 euro apo në shumë prej 20.22 euro nga data 18.04.2017 deri me datë 14.02.2019 si dhe 51.66 euro nga data 15.02.2019 deri me datë 18.04.2021. Në këtë drejtim, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësit për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 20.22 euro, për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 14.02.2019 apo për 21 muaj e 26 ditë pune, shumën e përgjithshme prej 442.14 euro. Pra, diferenca e papaguar në shumë prej 20.22 euro, duke e shumëzuar për 21 muaj

($21 \times 20.22 = 424.62$ euro) dhe kjo diferencë duke e llogaritur për 26 ditë ($20.22/30 = 0.674 \times 26 = 17.52$) apo në mënyrë të përmbledhur ($424.62 + 17.52 = 442.14$ euro). Ndërsa për periudhën kohore nga data 15.02.2019 deri me datë 18.04.2021, apo për 26 muaj e 6 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 51.66 euro, shumën e përgjithshme prej 1,353.49 euro. Pra, diferenca e papaguar në shumë prej 51.66 euro, duke e shumëzuar për 26 muaj ($26 \times 51.66 = 1,343.16$ euro) dhe kjo diferencë duke e llogaritur për 6 ditë ($51.66/30 = 1.722 \times 6 = 10.33$) apo në mënyrë të përmbledhur ($1,343.16 + 10.33 = 1,353.49$ euro).

Ndërsa sa i përket pjesës së kërkesëpadisë për periudhën kohore 18.04.2017 deri me datë 14.02.2019, gjykata e ka aprovuar kompensimin në emër të kualifikimit apo licencimit në lartësi prej 19% të pagës bazë, për faktin se nga diploma me numër 134, e datës 18.07.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka mbaruar studimet në nivelin bachelor me datë 15.02.2019, andaj gjykata ka vlerësuar se paditësja ka lidhur kontratën e punës si mësimdhënëse bazuar në kualifikimet e saj shkollore, dhe përkundër faktit se gjykatës nuk i ka bashkangjitur diplomën e shkollës së lartë pedagogjike, gjykata e mori si të mirëqenë faktin se e njëjta e ka të përfunduar këtë nivel shkollimi pasi që nuk do të kishte lidhur kontratë pune si mësimdhënëse po të mos kishte kualifikimin e duhur shkollor, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 23.03.2022, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër sa i përket pjesës refuzuese, gjykata i vlerësoi si të pa bazuara pretendimet e palës paditëse sa i përket lartësisë së pagës bazë të paditëses. Nga provat e bashkangjitura padisë, konkretisht nga lista e pagave gjykata ka vërtetuar se paga bazë e paditëses është në lartësi prej 393.00 euro, e jo siç ka pretenduar paditësja se është në lartësi prej 421.00 euro.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësit t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 144.00 euro, sipas Tarifës së Odës së

Numri i lëndës: 2022:054918

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05728916

Avokatëve, për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumë prej 40.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.984/2022, datë 24.05.2024

Gjyqtar
i,
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.